

Deklarata e Performancës

Data:	30.04.2026
AGJENCIA	Agjencia e Metrologjisë Kosovës - AMK
MINISTRIA PERGJEGJESE	MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT (MINTI)
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	PO

Vlerësimi përshkrues i Performancës

Gjatë vitit 2025, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ka realizuar një pjesë të konsiderueshme të objektivave të saj strategjike, veçanërisht në fushën e shërbimeve metrologjike dhe implementimit të standardeve ndërkombëtare. Është evidentuar progres në përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe në përmbushjen e kërkesave për akreditim, edhe pse disa objektiva nuk janë realizuar plotësisht për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore. Aktivitetet operative, përfshirë verifikimet, kalibrimet dhe inspektimet, janë realizuar në nivel të lartë dhe kanë kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e konsumatorit dhe funksionimin korrekt të tregut. Po ashtu, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në organizata relevante kanë forcuar kapacitetet profesionale dhe integrimin e AMK-së në rrjetet evropiane të metrologjisë. Në tërësi, performanca e Agjencisë vlerësohet pozitive me nevojë për përmirësim në aspektin e investimeve dhe akreditimit të plotë të laboratorëve.

Prioritet e Performancës

Një nga prioritetet kryesore ka qenë avancimi i laboratorëve drejt akreditimit sipas standardeve ISO 17025 dhe ISO 17020, ku është arritur progres i dukshëm në përgatitjen teknike dhe përmirësimin e dokumentacionit të cilësisë. Është synuar zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve laboratorike dhe rritja e kompetencës profesionale të stafit, përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në ndër-krahasime laboratorike ndërkombëtare. Një prioritet tjetër ka qenë plotësimi i kornizës ligjore, përfshirë hartimin e draft Ligjit për Metrologjinë dhe akteve nënligjore përkatëse, megjithëse miratimi i tyre ka mbetur në fazë të pjesshme. Agjencia ka vendosur theks të veçantë edhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve metrologjike dhe mbikëqyrjes së tregut, duke realizuar një numër të lartë verifikimesh, kalibrimesh dhe inspektimesh. Në fund, promovimi i metrologjisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar kanë qenë prioritete kyçe për rritjen e dukshmërisë dhe besueshmërisë institucionale.

Mimoza Kusari Lila

Ministre në detyrë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

